



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

**PËR NJOHJEN E SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË SIPËMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE TË LICENCUAR NË NJË VEND ANËTAR TË
BE-SË DHE NJOHJEN E SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE
ME PJESËMARRJE TË HAPUR ME OFERTË PUBLIKE NË TITUJ TË
TRANSFERUESHËM TË MIRATUAR NË NJË VEND ANËTAR TË BE-SË**

Miratuar me Vendim Bordi nr. 37, datë 31.03.2023

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës, rregullave dhe dokumentacionit për njohjen e shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuar në një vend anëtar të BE-së me qëllim marketimin dhe shitjen e aksioneve ose kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe njohjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të neneve 94, 96, 156, 200, 240 dhe 241, pika 1, të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 3

Përkufizime

Përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato në Ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 4

Njohja nga Autoriteti

1. Shoqëria administruese e licencuar në një vend anëtar të BE-së për të kryer administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike mund të marketojë dhe shesë aksionet ose kuotat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm në Republikën e Shqipërisë, vetëm pas njohjes nga Autoriteti.
2. Sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm e miratuar në një vend anëtar të BE-së e administruar nga një shoqëri e licencuar në një vend anëtar të BE-së, mund të marketohet në Republikën e Shqipërisë, vetëm pas njohjes së saj nga Autoriteti.

Neni 5

Agjenti i shitjes

Shoqëria administruese e njohur mund të marketojë dhe shesë kuotat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm nëpërmjet agjentit të shitjes sipas përcaktimeve të nenit 101, pika 2, të Ligjit nr. 56/2020, dhe në përputhje me rregulloren për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një shtet anëtar të BE-së.

Neni 6

Kriteret dhe dokumentacioni për njohje të shoqërisë administruese së sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuar në një vend anëtar të BE-së

Kriteret për njohje të shoqërisë administruese së sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të licencuar në një vend anëtar të BE-së janë:

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjeve së investimeve kolektive ose autoriteti rregullator i vendit të origjinës së shoqërisë administruese i ka përcjellë Autoritetit informacionin se shoqëria administruese:

- a) Është e licencuar për të ushtruar veprimtari në fushën e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- b) Është objekt i mbikëqyrjes në vendin e vet të origjinës duke specifikuar ligjin me të cilin mbikëqyret shoqëria administruese e licencuar në një vend anëtar të BE-së.
- c) Ka njoftuar autoritetin rregullator të vendit anëtar të BE-së për kryerjen e veprimtarisë së shitjes dhe marketimit të kuotave ose aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë duke i specifikuar këto sipërmarrje; dhe
- d) Mbi masat mbikëqyrëse në fuqi nga autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës.

Autoriteti, gjatë procesit të njohjes së shoqërisë administruese, nëse e gjykon të nevojshme konfirmon informacionin e marrë me autoritetin rregullator të vendit të origjinës së shoqërisë administruese.

2. Shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive e licencuar në një vend anëtar të BE-së e cila kërkon njohjen nga Autoriteti duhet të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Një përshkrim të përgjithshëm të qëllimit për të cilin bëhet kërkesa;
- b) Vendimin e organit drejtues të saj për të marketuar dhe shitur aksione ose kuota të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) Listën e SIK që do të marketojë në Republikën e Shqipërisë;
- d) Informacion për mënyrën e marketimit të SIK në Republikën e Shqipërisë;
- e) Listën me emrat e personave kyç dhe personelit kyç të shoqërisë administruese;
- f) Vendndodhjen e selisë qendrore së saj;
- g) Dokumentin e angazhimit dhe të dhëna mbi agjentin e shitjes të propozuar.

Neni 7

Kriteret dhe dokumentacioni për njohje të sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së

Me njohjen e shoqërisë administruese, me qëllim që sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm e miratuar në një vend anëtar të BE-së dhe e administruar prej kësaj shoqërie, të njihet nga Autoriteti duhet që:

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive ose autoriteti rregullator i vendit të origjinës së shoqërisë administruese i ka përcjellë Autoritetit informacionin se sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm:

- a) Është e miratuar për të ushtruar veprimtari në fushën e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike në vendin anëtar të BE-së;
- b) Është objekt i mbikëqyrjes në vendin e vet të origjinës duke specifikuar ligjin me të cilin mbikëqyret si dhe direktivën mbi të cilën është bazuar ky ligj;
- c) Nëse ka pasur gjatë vitit të kaluar ngjarje materiale të cilat do të ndikonin në performancën e saj.

Autoriteti, gjatë procesit të njohjes së sipërmarrjes së investimeve kolektive, nëse e gjykon të nevojshme konfirmon informacionin e marrë me autoritetin rregullator të vendit të origjinës së shoqërisë administruese.

2. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive duhet të depozitojë informacionin e mëposhtëm për sipërmarrjen e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm që kërkon të njihet:

- a) Dokumentin e angazhimit midis shoqërisë administruese të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe agjentit të shitjes që regjistrohet nga Autoriteti për të shitur aksione ose kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me kërkesat e nenit 102 të ligjit nr. 56/2020;
- b) Prospektin në gjuhën shqipe, të sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm, aksionet ose kuotat e së cilës do të marketohen dhe shiten në Republikën e Shqipërisë;
- c) Shtojcën e prospektit me informacionin në lidhje me mënyrën e marketimit dhe shitjes së sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm në Republikën e Shqipërisë;
- d) Dokumentin me informacionin kryesor për investitorin (KIID) në gjuhën shqipe, të sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm, aksionet ose kuotat e së cilës do të marketohen dhe shiten në Republikën e Shqipërisë;
- e) Raportin vjetor më të fundit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm;
- f) Programet dhe materialet e trajnimit që do të ndiqen nga stafi i agjentit të regjistruar i cili do të marketojë dhe shesë aksionet ose kuotat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi;
- g) Një përshkrim të trajtimit tatimor të mbajtësve të kuotave në Republikën e Shqipërisë;
- h) Procedurën për shitjen dhe procedurën në lidhje me trajtimin e ankesave për investitorët e Republikës së Shqipërisë; dhe
- i) Nëse sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm është një sipërmarrje furnizuese, informacion për sipërmarrjen e investimeve kolektive kryesore, përfshirë se ku është miratuar SIK kryesore, si dhe prospektin e saj.

Neni 8

Transparenca

1. Prospekti që do i vihet në dispozicion investitorëve në Republikën e Shqipërisë, hartohet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë një Shtojcë me informacionin lidhur me mënyrën e marketimit dhe shitjes së aksioneve ose kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend të BE-së në Republikën e Shqipërisë.
2. Investitorëve u vihet në dispozicion edhe dokumenti me informacionin kryesor (KIID).
3. Prospekti dhe (KIID), që u vihen në dispozicion investitorëve hartohen në gjuhën shqipe dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të agjentit të regjistruar nëpërmjet të cilit shoqëria administruese e njohur mund të marketojë dhe shesë kuotat e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm.

Neni 9

Shqyrtimi i kërkesës për njohjen

1. Autoriteti, gjatë procesit të njohjes së shoqërisë administruese të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe/ose të sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së, merr në konsideratë si më poshtë:
 - a) Autoriteti ka administruar informacionin e nevojshëm të përcaktuar në ligj dhe në këtë rregullore si dhe informacionet shtesë të kërkuara;
 - b) Ekziston bashkëpunimi i duhur mbikëqyrës midis autoritetit rregullator të vendit të BE-së të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe Autoritetit, nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi;
 - c) Shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive e licencuar në një vend anëtar të BE-së, ndërmerr masat e nevojshme për pagesën në Republikën e Shqipërisë të investitorëve për shlyerjen e aksioneve ose kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm dhe vënien në dispozicion të informacionit për investitorët që shoqëria harton dhe përgatit sipas rregullave të vendit të saj të origjinës;
 - d) Kërkesa është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së bashkëpunimit që Autoriteti ka lidhur me Autoritetin rregullator të vendit të BE-së.
2. Gjatë periudhës së shqyrtimit, Autoriteti mund të kërkojë çdo informacion të mëtejshëm që është i nevojshëm për të gjykuar mbi plotësimin e kriterëve nga subjekti kërkuar. Kërkesa për

plotësim dokumentacioni dhe/ose përmirësim i përmbajtjes së dokumenteve të depozituara i komunikohet subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike.

Neni 10

Afati i trajtimit të kërkesave, regjistrimi dhe njoftimi nga Autoriteti

1. Autoriteti, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe listën e dokumenteve të depozituara për njohje sipas ligjit nr. 56/2020 dhe kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti, nëse vëren se kërkesa e depozituar nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, i kërkon subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike, që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune të plotësojë kërkesën duke specifikuar dokumentet që mungojnë.
3. Nëse subjekti me kërkesë të argumentuar nuk është në gjendje të paraqesë ndonjë nga dokumentet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, afati shtyhet edhe me 30 (tridhjetë) ditë pune të tjera. Nëse subjekti kërkues nuk depoziton dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, Autoriteti nuk merr në shqyrtim kërkesën e paplotë dhe njofton me shkrim ose në mënyrë elektronike subjektin kërkues.
4. Autoriteti brenda 3 (tre) muajve nga marrja e informacionit të plotë për njohjen e shoqërisë administruese të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe/ose të sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së, merr vendim për njohjen ose refuzimin e njohjes dhe njofton autoritetin rregullator të vendit të BE-së si dhe subjektin mbi vendimin e tij.
5. Autoriteti regjistron në regjistrin përkatës çdo shoqëri administruese të licencuar në një vend anëtar të BE-së për të marketuar dhe shitur aksione ose kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë, dhe çdo sipërmarrje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së për të cilën është dhënë njohja. Regjistri i subjekteve publikohet në faqen e internetit të Autoritetit.

Neni 11

Ndërprerja e aktivitetit të sipërmarrjes së investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë

1. Nëse shoqëria administruese e licencuar në një vend anëtar të BE-së vendos të ndërpresë marketimin dhe shitjen e aksioneve ose kuotave për investitorët në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të njoftojë menjëherë dhe pa vonesa Autoritetin.

2. Autoriteti me marrjen e njoftimit çregjistron shoqërinë administruese të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe të njohur.
3. Shoqëria administruese e cila ndërpret marketimin dhe shitjen e aksioneve ose kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së, duhet të njoftojë investitorët në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet agjentit të regjistruar të shitjes. Njoftimi publikohet në gazetatat me qarkullim të përditshëm dhe në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese dhe agjentit të regjistruar të shitjes.

Neni 12

Detyrimi për informacion dhe raportimi në Autoritet

1. Shoqëria administruese e licencuar në një vend anëtar të BE-së pas njohjes, i mundëson Autoritetit çdo informacion që kërkohet për çështjet e lidhura me veprimtarinë e subjekteve të licencuara/njohura.
2. Shoqëria administruese e njohur i mundëson menjëherë Autoritetit çdo informacion që zotëron, nëse është në dijeni apo ka arsye të besojë se:
 - a. Informacioni është i rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore të autoritetit lidhur me subjektet e licencuara/njohura, sipas ligjit nr. 56/2020 dhe kësaj rregullore;
 - b. Mosdhënia e informacionit çon në keqinformimin dhe/ose mashtrimin e Autoritetit për çështje me rëndësi në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore të tij lidhur me subjektet e licencuara/njohura, sipas ligjit nr. 56/2020 dhe kësaj rregulloreje.
3. Shoqëria administruese e njohur informon menjëherë Autoritetin për çdo çështje që ka dijeni ose që ka arsye të besojë sa më poshtë:
 - a. Gjendja ekzistuese ose e ndryshuar e aktivitetit mund të rrezikojë të drejtat e mbajtësve të aksioneve ose kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të administruara nga shoqëria administruese;
 - b. Çdo veprimtari kriminale që lidhet me ofrimin e shërbimeve të tyre, përfshirë veprimtaritë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
4. Shoqëria administruese e njohur, informon Autoritetin nëse ka ndryshime lidhur me:
 - a) Emërimin dhe shkarkimin e personave kyç dhe personelit kyç;
 - b) Fillimin ose ndërprerjen e planifikuar të veprimtarive;
 - c) Marketimin; dhe
 - ç) Kontratat e lidhura me agjentët e shitjeve të regjistruar.

Neni 13

Revokimi i vendimit të njohjes së shoqërisë administruese dhe/ose sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së

Autoriteti mund të revokojë vendimin e njohjes së subjektit nëse:

- a) Nuk përmbushen më kërkesat e nenit 96, pikës 4, germave ç), d) ose dh), të ligjit nr. 56/2020;
- b) Autoriteti i vendit të BE-së, merr masa për revokimin e licencës së shoqërisë të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe/ose sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së;
- c) Janë shkelur kriteret e përcaktuara për njohjen sipas ligjit nr. 56/2020 dhe kësaj rregullore;
- ç) Nuk përmbushen kërkesat që investitorëve në Republikën e Shqipërisë, t'i vihet në dispozicion dokumentacioni në gjuhën shqipe;
- d) Shkelen kërkesat rregullatore të Autoritetit për transparencë kundrejt investitorëve.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.